VENDIM
Nr. 17, datë 11.1.2017

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 90 HA QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA "LALA-06" SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË HEKUR-NIKELIT NË OBJEKTIN "PLASË", BASHKIA MALIQ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore dhe kullosore publike prej 90 (nëntëdhjetë) ha që do të përdoret nga shoqëria "Lala-06" sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të hekur-nikelit në objektin "Plasë", të hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor publik i Bashkisë Maliq, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga regjistri i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja me të dhënat mbi sipërfaqet pyjore dhe kullosore që pakësohen në volum dhe hiqen nga fondi pyjor dhe kullosor publik si dhe harta topografike me koordinatat e poligonit të sipërfaqes objekt minerar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, produkteve të tjera pyjore dhe kullosore dhe të investimeve të kryera në vite, objekt i këtij vendimi, paguhen nga shoqëria "Lala-06" sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391 datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", të ndryshuar, dhe derdhen në llogarinë bankare të Bashkisë Maliq.

3. Shoqëria "Lala-06" sh.p.k., të pyllëzojë me fondet e veta 170 (njëqind e shtatëdhjetë) ha me drurë pyjorë, dhe të përmirësojë 28 (njëzet e tetë) ha kullotë sipas afateve të përcaktuara në marrëveshjen e lidhur ndërmjet kësaj shoqërie dhe Bashkisë Maliq.

4. Bashkia Maliq dhe shoqëria "Lala-06" sh.p.k., nënshkruajnë marrëveshjen e bashkë-punimit, jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes së bashku me projektet e miratuara dërgohet për monitorim në Ministrinë e Mjedisit, jo më vonë se 10 ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Publike bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore dhe kullosore të identifikuar sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi, nga kategoria "Tokë e zënë pyjore dhe kullosore" dhe e regjistron në kategorinë "Tokë e zënë, objekt i aktivitetit minerar të shfrytëzimit të hekur-nikelit".

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit, sipas lejes mjedisore nga shoqëria "Lala-06" sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullosor publik të Bashkisë Maliq.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Maliq dhe shoqëria "Lala-06" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Bashkia MALIQ

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN PËR SHFRYTEZIMIN E FE-NI NGA SUBJEKTI "LALA - 06" shpk

Nr.	ID pones	Ekonomia pyjore/Kullosore	Ng/ n/ngast.	Siperfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/ kullosor ha
1	*2*	*3*	*4*	*5*
1	KO70 00 015	Zemblak Qarr	15	12
2	KO70 00 016	Zemblak Qarr	16	14
3	KO70 00 020	Zemblak Qarr	20	23
4	KO70 00 021a	Zemblak Qarr	21a	3
5	KO70 00 021b	Zemblak Qarr	21b	7
6	KO70 00 022a	Zemblak Qarr	22a	12
7	KO70 00 022b	Zemblak Qarr	22b	10
8	KO70 00 022c	Zemblak Qarr	22c	9
GJITHSEJ				**90**


Poligon 0.9 km2
Ekonomia Pyjore
Zemblak-Qarr.
Parcelat pyjore qe ze
jane: 15,
16,20,21a,21b,22a,22b,
22c
Plasa
15
20
21
22
23
24a
19
25a
18
11
Kuçi Zi
833.0
stalla
kas.
rez.
9-4
5
10-3
15
10-6
20
SMT